



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

## E K S T R A K T I

**Nga procesverbali i mbledhjes së 32-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 25.07.2024, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10<sup>00</sup>**

### **Në mbledhje prezantuan:**

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Nexhmedin Lekiqi, anëtar
3. Shefki Bytyqi, anëtar
4. Gazmend Qerkini, anëtar
5. Shkelzim Olluri, anëtar
6. Albiona Tasholli, anëtare
7. Fadil Sopa, anëtar
8. Sami Bytyqi, anëtar
9. Fitim Shala, anëtar
10. Xhyzide Rrustemi, anëtare
11. Rinor Murati, anëtar
12. Armend Grajqevci, anëtar
13. Gjentianë Hoxhaj, anëtare
14. Venhar Agushi, anëtar
15. Xhyla Dedushaj, anëtare
16. Majlinda Sylejmani, anëtare
17. Lulzim Rrustemi, anëtar
18. Herolind Kozhani, anëtar
19. Ardit Cani, anëtar
20. Arsim Jashari, anëtar
21. Egzona Bytyqi, anëtare
22. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
23. Ganimete Qeriqi, anëtare
24. Alban Salihu, anëtar
25. Fitim Meziu, anëtar
26. Fadil Spahiu, anëtar
27. Fatmir Fetahu, anëtar
28. Shahadije Dragaçina, anëtare
29. Besiana Sylja, anëtare
30. Enver Kryeziu, anëtar
31. Bashkim Budakova, anëtar

### Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, kryetar i komunës
2. Lulzim Qerimi, nënkryetar i komunës
3. Latif Ramadani DBF
4. Shkelzen Hajdini, DSH
5. Elmaze Behluli, DA
6. Sead Aliu, DI
7. Rexhep Rexhepi, DBP
8. Rasim Hasani, DA
9. Safete Amerrlahu, DGJK
10. Burim Rrustemi, DSHPMSh
11. Imri Semetishti, DUPMM
12. Anila Reqica-LLugiqi, DKRS
13. Përfaqësues të mediave dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit, tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë me kohë, pastaj lexoi rendin e ditës të propozuar.

### REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 31 -të e Kuvendit-së.
2. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Qershor 2024.
3. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Lipjanit për vitin 2023 dhe plani i zbatimit të rekomandimeve të auditorit të pranuar me raportin final nga Auditori i Zyrës Kombëtare të Kosovës për vitin 2023, të cilin auditim e ka kryer Zyra Kombëtare e Auditimit.
4. Raporti vjetor i NJAB për vitin 2023.
5. Propozim Rregullore për ndryshimin e plotësimit të rregullores për transportin e rregullt urban periferik të udhëtareve me autobus 15nr.011-7239 e datës 31.01.2019
6. Propozim vendim për miratim të planit të orarit të rrethit të udhëtimeve për linjat e transportit të udhëtareve me autobus në territorin e komunës së Lipjanit 2024-2028
7. Propozim vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit P-71409036-00164-15.
8. Propozim vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit P-71409036-00164-51.

9. Propozim vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit P-71409036-00164-18.

10. Propozim vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit P-71409036-00164-27.

11. Propozim vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit P-71409036-00164-21.

Pastaj Kryesuesi tha se e kam një propozim që të hiqet nga reni i ditës një pikë, po ashtu edhe propozim për 3 pika shtesë.

Pika e cila kërkoj që të hiqet nga rendi i ditës është pika e 11-të e rendit të ditës për të cilën pikë kam marr ankesë nga një biznes i cili ka bërë një ankesë në gjykatën komerciale, pas konsultimeve me zyrën e kryetarit kemi edhe këtë propozim.

Pastaj ia kaloi fjalën kryetarit të komunës.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha, pasi që muaji gusht do të jetë muaj i pushimit, ne kemi disa propozime për shkak të natyrës që kanë, e para,

1. Vendim për transferin dhe rialokimin e mjeteve 2024, ne e kemi aprovuar seancën e kaluar ridestinimin por thesari nga ka marr mjetet për shkak të borxheve nga kontrata kolektive, nëse nuk e fusim tani do të jetë shumë vonë deri në shtator.

2. Vendim për lirim nga pagesa e taksave për shfrytëzimin e hapësirave publike –terasave vend parkingjeve për operatorët e auto taksi dhe qiramarrësit e lokaleve në pronësi të komunës. Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiarë për klubin futbollistik Gadimja, Një klub në themelimin e sipër mua nuk me takon më nga 5 mijë euro për këtë e kam propozuar për kuvend.

Arsim Jashari, tha ne nuk jemi kundër këtyre propozimeve por të paktën duhet të vijmë në KPF që të shohim dhe të diskutojmë, por prapë ne i mbështesim këto 3 pika si grup i PDK-së.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se nuk kanë qenë gati për KPF, sepse në çdo herë i bijmë në KPF, kur janë gati.

Alban Salihu, tha se mendoj që duhet me i pas ma herët propozimet që me i diskutuar ashtu siç e dha edhe parafolësi.

Daut Azemi, tha ne vazhdimisht i kemi pruar këto propozime.

Lulzim Rrustemi, është mire pasi qe po hiqet pika e 11-te, me na pajis me materialin e gjykatës për këtë pikë.

Pastaj Kryesuesi i kuvendit hodhi ne votim propozimin për tërheqjen e pikës 11. Propozim vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit P-71409036-00164-21 dhe pas votimit u konstatua se me 27 vota për 4 abstenime, u aprovua propozimi.

Pastaj Kryesuesi propozoj pikat shtesë,

Vendim për transferim dhe rialokimin e mjeteve 2024

Vendim për lirim nga pagesa e taksave për shfrytëzimin e hapësirave publike –terasave vend parkingjeve për operatorët e auto taksi dhe qiramarrësit e lokaleve ne pronësi te komunës.

Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiarë për klubin futbollistik Gadimja,

Me 26 vota për 4 abstenime u aprovua propozimi.

Pastaj Kryesuesi i kuvendit Daut Azemi, tha se propozoj rendin e ditës komplet për votim, pas votimit u konstatua se Kuvendi me te 26 vota për 4 abstenime aprovoi Rendin e Ditës se propozuar.

Pastaj u kalua në pyetjet e anëtarëve të kuvendit?

Arsim Jashari, tha se kam disa kërkesa dhe pyetje, e para seancën e kaluar nuk ka funksionuar fare zëri ku 20 minutat e para te mbledhjes nuk është dëgjuar asgjë është mirë me marr masa. Kërkesa e dyte te cilën e kam paraqite edhe me herët është për plotësim ndryshimin për rregulloren për varrezat te ndryshohet një nen ku afër shtëpive afër 250 metra mos te bëhen varreza. Çka po ndodh për ndërtimin ilegal banesor te cilën e kam ngrit edhe mbledhjen e kaluar. Pyetje për drejtorinë e shëndetësisë për anulim te konkursit për gabim teknik, me ligj për gabim teknik brenda 5 dite duhet me u shpallë prapë. Pse është anuluar ai konkurs. Pyetja tjetër për te njëjtën drejtori, para disa dite ka ndërruar jete një grua e moshuar, kur është vizituar për herë te fundit nga menaxherja apo zyrtarja, me sa kam informatë unë, nuk është vizituar, presim një informatë nga ana juaj. Dhe e fundit ne cilin vend te botës mund të ndodh që pas 24 viteve me fituar statutin e dëshmorit, informata qe i kam nga 21

dëshmor do te behën 31 dëshmor. Ska me na fal historia ketë dhe kjo është e pa papranueshme dhe ju kisha lut te gjithëve qe mos te pranohet kjo.

Ardit Cani, tha se kam disa kërkesa, është një kërkesë e banorëve te fshatit Mirenë për asfaltimin e rrugicës Troja. Kërkesa e dytë është për asfaltimin e rrugës ne lagjen Hodiqi në Magurë rrugë për rreth lagjes Bardhi ku janë afër 25 shtëpi. Kërkesa tjetër për pastrimin e lumit Drenica të cilën e kemi diskutuar disa herë, pasi gjatë dimrit po shkakton probleme.

Egzona Bytyqi, tha se ne kohen e fundit kam marr disa ankesa nga lagja e Doktorëve ne Lipjan, për zhurmën e motoçikletave sikur të ishte një garë aty, dhe kërkohet nga organet e sigurisë të marrin veprime konkrete për këtë çështje. E dyta temperaturat e larta na kane ataku te gjithëve por me se shumti ata me sëmundje kronike, e të tjera. Problematike është ata kur kane kërkua ndihme edhe aty nuk ka pas kondicioner dhe kërkoj nga drejtorja e shëndetësisë te ketë kondicioner. Çështja tjetër drejtorja e inspektionit ka fluks te madh te punës, por ka ankesa qe nuk ka përputhje te çmimeve ne raft dhe arkë, e dyta a janë ndërmarr masa për shitësit ambulativ qe shesin në mbrëmje te sheshi ku shumicën e rasteve nuk ngjason me shesh por sikur te ishte treg. Ankesë tjetër shqetësuese nga regjioni i Magures ku ka produkte qe janë te mbyllura ne mënyre mekanike. Tjetra ndriçimi publik ne disa vende gjate ditës po jetë i ndezur ndoshta mundet me qene edhe ndonjë defekt a do te sanohet. Seancën e kaluar kemi marr informate qe deponia sanitare do te vendoset ne Qylage, a ka ndonjë lëvizje ne ketë drejtim e uroj qe mos te këtë.

Lulzim Rrustemi, tha i kam disa kërkesa, është mire me intervenuar te parku te hekurudha pasi qe është ne gjendje jo te mirë është një shatërvan i shkatërruar. Ka nevojë për intervenim. Kam vërejte për mirëmbajtjen e hapësirave te gjelbërta me pas më shumë gjelbërim dhe lule, po ashtu edhe të shtohen intensiteti i grumbullimit te mbeturinave të pastrimit te rrugëve. Propozoj qe muaji gusht te shfrytëzohet për rregullimin e sallës së Kuvendit.

Ganimete Qeriqi, tha se një defekt rrugor te ura në Krojmir ku është një urë shumë e ngushte aty ku nuk mund te kalojnë dy automjete, dhe si preventive duhet te vendosen disa mbrojtës me ndriçim ose disa pengesa ne rruge deri te vijne deri te ura, pasi qe është një vend i rrezikshëm për ata qe se njohin atë teren. E dyta ne Krojmir te varrezat e **Qiriqve** kane filluar banoret ne mënyre vetanake ti pastrojnë varrezat a ka tender komuna për me i pastrua ose jo.

Alban Salihu, tha se kam disa çështje, e para ka te bëjë me një rrugë ne fshatin Baincë, ku një **qytetarë** me ka kontaktuar për diskriminimin qe ja ka bërë komuna ati dhe lagjes ku banon ai gjatë asfaltimit të rrugëve. E dyta gjate muajit qe lamë pas qytetaret e Lipjanit janë përball me situata te vështira te cilat janë shkaktuar nga operatorë ekonomik te cilën po zhvillojnë punime ne projekte te komunës se Lipjanit njëherë dëmtuan gypat e ujërave të zeza ,pastaj dëmtuan kabllot e internetit duke len pa internet Agjencinë për Regjistrim Civil për disa ditë, pastaj dëmtuan edhe gypat e ujësjellësit ku qytetaret për disa ditë mbeten pa ujë te pijes. E treta, para disa dite një aktivist i yni e ka shpërnda një foto ku kryetari i komunës duke pire kafe me pronarin e një kompanie ku merr shume punë prej komunës se Lipjanit, a përben konflikt interesi kjo ne mënojmë qe po? Dhe çështja e fundit qe dy vite u pata ndal ndërtimet ne komunën e Lipjanit si pasoje miratimit te hartës zonale, ku miratimi i tyre pati afektuar kryesisht ne zonën qendrore, mirëpo këto dite ka filluar ndërtimi i një objekti banesor në zonën e qytetit, si është e mundur qe tani nuk janë plotësuar kriteret ndërsa tani po.

Shahadie Dragaçina tha se çështja te cilën do ta ngris është fakti se komunës se Lipjanit i është refuzuar nga Ministria e Infrastrukturës parcela qe komuna e ka zgjedh për banim të përballueshëm apo social nga programi i qeverisë. Ne kemi disa raste qe kryetari ka akuzuar se qeveria nuk po investon ne Lipjan dhe kjo dëshmon te kundërtën. Ky kryetar nuk ka dhëne një pronë afërt qytetit. E dyta banoret e komunës se Lipjanit qe disa vite po përballen me ujë te pijes dhe kërkoj nga kryetari qe tu ju beje një zgjidhje këtyre qytetareve.

Lumturije Bytyqi-Hasani, kam disa çështje qe lidhen kryesisht me sheshin e Lipjanit, e të cilat po i ngrisim po thuaj çdo vit, e pra shitësit mobil ne mbrëmje kur hyn ne shesh sikur me hy ne treg, mirëpo shteti ka rregulla dhe ligje. E dyta te funksionalizohet zyra për promovimin turizmit, pse nuk po funksionalizohet sidomos ne ketë sezone qe ka turist nga venet e tjera. Tjetra kryetari ka marr vendim për ndalimin e trotineteve dhe motoçikletave ne shesh, mirëpo ajo nuk po zbatohet. Tjetra ne rrugën Gjergj Fishta, nuk ka ndriçim publik qe disa ditë çka po ndodh. Kam kërkuar rritjen e pikave te kontejnerëve ne qytetarin e Lipjanit mirëpo nuk kam pare ndonjë lëvizje, e krahas kësaj te shtohen dhe oraret e mbledhjes se mbeturinave. Qentë endacak ne kemi nda 10 mije euro për këtë çështje shqetësuese çka ka ndodh me te, nëse ka nevojë duhet te ndajmë prape mjete si kuvend dhe te zgjidhet ky problem.

Gentianë Hoxhaj, tha se parkingu nëntokësor qe po zhvillohen punimet, objekti i Agjencisë se Regjistrimit Civil apo i pengon punimet dhe a pritët te dislokohe. E dyta disa objekte te vjetra te tregu i gjelbër ne Lipjan a pritët te rrënohen a ka ndonjë

plan konkret komuna për ato objekte. Dhe a parashihet te ndërtohet diçka aty? A ka mundësi te ipet një hapësirë për gratë që merren me produkte vendore ne atë pjese.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se rregullorja e varrezave ide që është thënë dhe me herët, mirëpo ne disa fshatra janë me afër se 250 metra varrezat si ne Janjevë Brus dhe fshatra tjera. Te anulimi i konkursit ka pas një defekt sepse udhëzimi i ri Administrativ thotë që nga kryetari i komunës te shpallet konkursi jo nga drejtori. Vdekja e një të moshuari, ne banesën e tij, informatat i kam nga policia por nuk e kam informatën për departamentin përkatës a e ka krye detyrën ose jo. Rruga te lagja Hodiqi aty ka rrugë, por ai po lyp rrugë alternativë. Kontrata për pastrimin e lumenjve u shpenzuar. Zhurma e motorëve dhe veturave është shqetësuese por se bashku me policinë duhet te bisedojmë që me i minimizuar këto. Mos përputhje te çmimeve jemi në dijeni dhe inspektorati ka intervenuar disa here. Te sheshi ju ka tërheq vërejtja shitësve ambulativ, dhe ata nuk kane leje nga ana jonë. Ndriçimi publik po ndodh ndonjëherë që po është i ndezur, për shkak te ndonjë prishje. Deponia e mbeturinave ka lëvizje qeveria i ka shpronësuar tokat ne skemi pranua asnjë marrëveshje me ta dhe ju kemi thënë që do te ju kundërshtojmë pasi që është vend i pa përshtatshëm aty. Parku te hekurudha e drejte dhe shume shpejte do te heqim aty dhe do ta mirëmbajmë, Shportat e reja te mbeturinave janë shpërnda ne disa pjese do te shpërndahen dhe disa tjera. Te lokacioni për banimin e përballueshëm komisioni i Qeverisë vet e ka pranuar atë lokacion tonë si të përshtatshëm për ta ndërtuar. Por si duket kur ka shkuar ne qeveri e kanë anuluar. Qentë endacak kemi pas një kontrate 2 vjeçare, ne duhet te hyjmë prape ne kontratë, por do te jetë telashe pasi që vijnë edhe nga lokalitet tjera qentë. Ujësjiellësi nuk menaxhohet nga ana jonë. Qendra e regjistrimit civilë, e para është ne prone te komunës, e dyta ne marrëveshjen e nënshkruar mes komunës dhe tyre thuhet kurdo që i vyen komunës munden me hekë ata, e treta ska leje fare, e katërta nuk eshët fare e regjistruar. Ne i kemi dhënë disa propozime te sociali ose te ish komuna e re , njëherë është pajtuar komisioni, pastaj pasi që kane shkuar ne Qeveri nuk e kanë pranuar. Objektet e vjetra te tregu do të rrënohen kemi ardhë ne fund të procedurave dhe do te rrënohen ato objekte. Në treg do te këtë edhe kioska që do të ju epen në shfrytëzim peronave që mirrën me prodhime vendore.

Imri Semetishti, tha dola për ta dhen një sqarim për një leje ndërtimore në qendër te qytetit përkatësisht ne pjesën ku do te vazhdohet ndërtimi i sheshit, ne vitin 2013 është marr një vendim për këmbimin e pronave private me prona komunale, ne vitin 2018 është riperti vendimi dhe është lidhur kontrata pasuese, që nga ai vit deri ne vitin 2023 eshët dal prapë vendimi ne kuvend për një afat shtese për atë zonë, unë ndihem mire që pas 11 vite i kemi dhënë zgjidhje atij projekti. Unë ndihem mire që e

kemi përfunduar këtë duhet respektuar vendimet e kuvendit dhe hartën zonale dhe është dashtë me gjet zgjidhje për ta ç'bllokuar këtë situatë. Te banimi i përbalueshëm jemi marr shume se bashku me drejtoratin për shëndetësi dhe urbanizëm zgjidhja ka qene ne Magure por kompania e ministrisë ka bere vlerësimet dhe sipas tyre ne i kemi plotësuar kriteret, kjo është e vërteta.

Arsim Jashari, tha se unë e pata fjalën për ato fshatra ku ka hapësirë për varreza dhe është mire me i ndaluar me varrose ne prona private.

Alban Salihu, tha se sa i përket banimit te përbalueshëm social është bërë hajgere me një kërkesë me një projekt qe mundet me qenë shumë i rëndësishëm për shume familje për shume qifte qe e fillojnë jetën e re. Kriteret kane qen te përcaktuara qartë ne zone urbane.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se për mua edhe Magurja edhe fshatrat tjera janë sikurse Lipjani. Edhe unë askujt si kam premtuar banesa për qifte te reja. Unë kam synime me i zhvilluar edhe zonat tjera dua me shtri zhvillimin edhe në vendet tjera. Tjetra unë nuk i iku asnjë biznesmeni te Lipjanit, pasi qe janë taksapagues te Lipjanit dhe qytetarë te këtij vendi.

Pasi që çështje tjera nuk pati u kalua me punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

## I

### **Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 31-të e Kuvendit**

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, vuri në votim ekstraktin nga mbledhja e 31-të e Kuvendit, pas votimit konstatoi se Kuvendi me, 24 vota për aprovoi

### **Ekstraktit nga mbledhja e 31 e Kuvendit.**

**Shtesë:** Ekstrakti

## II

### **Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Qershor 2024.**

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit, DBF, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Raporti



Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, tha se do te ndalem ne pika te shkurta sa i perket raportit te buxhetit. Do te ndalem te buxheti sipas fondeve burimore te grandit qeveritar jane shpenzuar pak, te te hyrat vetanake kemi dhe ketu shpenzim te vogel po ashtu te te hyrat e bartura. Te donacionet kemi shpenzim zero. Sipas kategorive ekonomike edhe ketu kemi shpenzim te vogel te buxhetit. Te investimet kapitale po ashtu edhe ketu shpenzim i vogel. Une do te ndalem te dy kategori te investimet kapitale dhe te te hyrat e bartura, ku kemi 10 projekte me shpenzim zero, ku prijne DKRS-ja, Drejtoria e Arsimit. Keto e kanë fushen e rrezikut sepse jane ende zero. Te tatimi ne prone nje arritje e mire. Realizimi nga lejet ndertimore eshte mirepo po ashtu edhe te taksat per leje ndertimore. Ndersa te tregu i hapur si duket nuk kane paguar asnjehere.

Shahadije Dragaçina, tha se nese e shohim kete raport shihet se i gjithë buxheti ka shkuar ne projekte te nenkalimit dhe sheshit dhe parkingut nentokësor ne qender. Ajo qe dua te theksoj fakti qe e kam ngritur edhe me heret se me keto investime i jane shkaktuar deme te medha bizneseve. Po ashtu me keto projekte jane anashkaluar investimet ne fshatra. Ku ne shume fshatra mungojne gjerat me elementare kanalizimi uji e te tjera.

Latif Ramadani, tha se projektet te cilat nuk jane kryer nuk jane ne raport, por ne raportin e ardhshem do te perfshihen, po ashtu edhe te projektet zero jane projekte qe ende nuk akne filluar. Ne sot po flasim per shpenzimet gjate vitin e jo per projektet qe do te jene.

Pastaj u kalua ne piken ne vazhdim.

### III

**Raporti i auditimit per pasqyrat financiare vjetore te Komunës së Lipjanit per vitin 2023 dhe plani i zbatimit te rekomandimeve te auditorit te pranuar me raportin final nga Auditori i Zyrës Kombëtare të Kosovës për vitin 2023, të cilin auditim e ka kryer Zyra Kombëtare e Auditimit.**

Lidhur me kete pike kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalen Safet Krasniqit auditor i mbrëmshem i cili, ne vazhdim i njoftoi te pranishmit me te dhënat nga raporti.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se po me intereson te qeto 27 rekomandimet sa është afati qe me u përmirësuar këto rekomandime. Ne po kemi mangësi ligjore kontrata kolektive po shkaktojnë probleme, a keni mujt me bo zgjidhje, a keni diskutuar me gjet një modalitet qe me u paguar e jo me shkua përmes gjykatës.

Lulzim Rrustemi, tha se kemi një rezultatet te mire, por kemi disa qe po na përsëriten, për shembull mangësi për leje te ndërtimore dhe legalizim, nuk ka nevoje me u vonua përgjigje 30 dite por duhet me u përgjigj brenda afatit kjo është përsëritë dhe vitin e kaluar. E dyta te raportet te përfituesit e subvencioneve. Mangësi për procedurat për angazhimin e konsulentët. Kosto shtese te vendimet gjyqësore. Është mirë këtë rekomandime te përmirësohen. Po ashtu është edhe një gabim teknik janë 9 rekomandime jo 10 të. Dhe është mire për komune qe ka një raport te tillë dhe e përshëndesim.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se, unë jam i kënaqur qe për disa vite me radhe e marrim raportin e auditorit i pa modifikuar. Është mire qe kemi zyrtarë qe akne arrite performace te mire dhe ne nivel te kënaqshëm te punës. Te detyrimet kontingjente ose obligimet qe na vijnë prej gjykatës është shtire e parashikueshme se sa vendime gjyqësore do te nxjerrën dhe shtir është me vlerësua. Jemi ne telashe me kontratën kolektive. Te disa rekomandime te cilat me shume janë administrative, mungesa e trajtimit për leje ndërtimore, pasi qe këta marrin leje dhe nga KEDS apo ndonjë organ tjetër dhe kjo shkakton telashe. Te subvencionet jemi te klubet sportive ku nuk kane raporte ,ku na jemi ne hall ose me ju ndal subvencionet ose mi pranua raportet. Na presin sfida sidomos te detyrimet kontingjente. Ky raporti i këtij viti është raporti me i mire deri tanoi qe e kemi marr.

Safet Krasniqi, kemi kërkuar ndihme për detyrimet kontingjente edhe për çështje tjera edhe nga USAIDI dhe ministritë mirëpo nuk po asnjë lëvizje. Ne kemi afat 30 ditë për zbatimin e rekomandimeve.

Pastaj u kalua ne pikën në vazhdim.

#### IV

### **Raporti vjetor i NJAB për vitin 2023.**

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Safet Krasniqit, auditor i brendshëm, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Imri AHmeti, kryetar i komunës tha se një nder sektor me te rëndësishëm te komunave janë auditorët te cilën e monitorojnë dhe rekomandojnë. Unë skam çka i shtoj më shumë raportit.

Pastaj u kalua ne piken ne vazhdim.

Pastaj kryesuesi dhe pauzë nga ora 12:00 deri ne 13:30

## V

### **Propozim Rregullore për ndryshimin e plotësimit të rregullores për transportin e rregullt urban periferik te udhëtareve me autobus 15nr.011-7239 e datës 31.01.2019**

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Burim Rrustemi, drejtor i DSHPMM-së i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 vota për, aprovoi propozimin

## VI

### **Propozim vendim për miratimit te planit te orarit te rendeve te udhëtimeve për linjat e transportit te udhëtareve me autobus ne territorin e komunës se Lipjanit 2024-2028**

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Burim Rrustemi, drejtor i DSHPMM i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, ne si grup i PDK-së, e mbështesim këtë propozim vendim, por e kemi një propozim qe te ketë ndriçim publik te stacioni, po ashtu edhe propozimin e fitimit qe te ketë një linje te autobusëve deri ne aeroport nga Lipjani. Dhe në fund një vërejte qe këto kompaninë qe po i marrin vijat te i mbajnë me autobus e jo pastaj me taksi se nuk është e drejte.

Shahadije Dragaçina, tha se unë kam vetëm një sqarim për tabelën e linjave te orareve Teqe Janeve Lipjan, mirëpo ne te kaluarën nuk ka funksionuar kjo linjë, tani a do et jene këto lindja ne baze te këtij plani si është e rregulluar.

Ardit Cani, tha se kam një propozim qe te linja e autobusëve Shale Lipjan qe kalon afër Bainsës, te hyje autobusi edhe brena fshatit pasi qe banoret e Bainses po detyrohen te dalin jashtë fshatit ne largësi afër 2 kilometra, e propozoj qe kjo linje te jetë deri te shkolla e fshatit.

Burim Rrustemi, tha se ne e kem obligim ligjor me i përfshi te gjitha fshatrat, pastaj hapin konkurs për licencim për këto orare dhe varet prej interesimit te tyre a kane ose jo për këto vija. Disa vija janë edhe te ministrisë se infrastrukturës.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 28 vota për , aprovoi propozimin

## VII

### **Propozim vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit P-71409036-00164-15.**

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacollit DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për, 5 kunder,1 abstenim, aprovoi propozimin

## VIII

### **Propozim vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit P-71409036-00164-51.**

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacolli, DSHPS, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se e kam edhe një rast qe është ankuar ne gjykatën komerciale, nëse është dorëzuar lënda ne gjykate është keq me kalua na, është mire me u konsultua dhe me tërheq këtë lëndë. Përndryshe ne do ta mbështesim.

Daut Azemi, tha se unë zyrtarisht nuk e kam asnjë njoftim për ndonjë ankese tjetër ne gjykatë. Unë skam zyrtarisht asgjë deri me tani.

Alban Salihu, tha se unë po e jepi qëndrimin për te gjitha pikat nga 7 deri 11 pasi qe janë te natyrës se njëjte, mendoj se procesi nuk ka qene transparent sa duhet, pasi qe behet fjale për prona qe kane vlerë të lartë financiare. Ne si grup i VV-së kemi marr shkresa me fakte qe procesi nuk ka shkuar si duhet. Por nuk mu ka duk ne rregull, për një gabim teknik, janë eliminuar, ne për shkak te këtyre dyshimeve do të votojmë kundër.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se komisioni ka bërë një punë voluminoze dhe ka kryer punën ne mënyrën me te mire dhe kane pas përgjegjësi. Nëse dikush është eliminuar për një gabim teknik këta kanë shpall një konkurs dhe aty ka pas kriteret nëse si ka plotësuar nuk është pranuar. Dhe secili vendos ne mënyrën e vet si voton.

Arsim Jashari, tha se nëse ka ardhe zyrtarisht ne arkiv mund ta terhjekim nëse nuk ka ardhe jemi ne rregull.

Armend Grajqevci, tha se ne si anëtarë te komisionit kemi pas një punë shume voluminoze dhe me përgjegjësi te madhe për shkak te vlerës te madhe që kanë ato prona. Ajo qe dua ta theksoj edhe një here që e tha edhe kryesuesi i këtij komisioni ne kemi bërë punën më të mirë të mundshme dhe kërkoj nga ana juaj qe ta mbështetni.

Lulzim Rrustemi, tha se unë jam idhtar i dhënies se pronës ne shfrytëzim, jo vetëm tani por kam qene edhe me herët dhe zhvillimin ekonomik Lipjani duhet me marr, duke ju dhënë njerëzve qe kane mjete kane projekte dhe kane zhvillim. Ne nuk mundemi me i lëne zonat me te mira pa zhvillim. Dhe ne si komision i kemi konsultuar te gjitha ligjet dhe aktet tjera ne mënyre detale dhe poentimi është bere ne bazë të kriterëve te konkursit. Ne jemi për me i përkrah këto oferta. Dhe të kisha lut kryesues që mos te përdorni standard te dyfishte.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se nuk po përdori standard te dyfishte, tregova edhe me herët unë nuk kam shkrese zyrtare e as te kryetari e as te drejtori nuk ka.

Valon Pacolli, tha se i falënderoj anëtarët e komisionit që kanë bërë një punë voluminoze dhe aspak të lehtë, dhe për të gjitha këtë ka procesverbale dhe dokumente. Ne si komision kemi vlerësuar këto. Deri me tani nuk kemi asnjë shkresë zyrtarë për ndonjë kërkesë apo ankese tjetër.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për 5 kundër, 1 abstenim, aprovoi propozimin

## IX

### **Propozim vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit P-71409036-00164-18.**

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacolli, DSHPS, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Bashkim Budakova, tha se në subjekt i AAK-së, kemi pranuar një shkresë që është paraqitur një padi në gjykatë për ndalimin të ekzekutimit të aktit administrativ për parcelën e shpallur. Pyetje ime është a mund të vendoset për një çështje që ka padi apo zhvillohen procedurë gjyqësore.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se e dhashë edhe me herët sqarimin për këtë çështje edhe unë edhe drejtori, në zyrtarisht nuk kemi asnjë informacion, nëse e ka dërguar të ju personi ka gabuar është dashtë zyrtarisht me derëza të institucioni.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 24 vota, për 5 kundër 1 abstenim aprovoi propozimin.

## X

### **Propozim vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit P-71409036-00164-27**

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacolli, DSHPS, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për 5 kundër 1 abstenim, aprovoi propozimin.

## XI

### **Vendim për transverin dhe rialokimin e mjeteve 2024**

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit, DBF, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se grupi i PDK-së e mbështesim këtë propozim, gjithçka që është në të mirë të qytetarëve në të mbështesim.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për 4 kundër, aprovoi propozimin

## XII

### **Vendim për lirim nga pagesa e taksave për shfrytëzimin e hapësirave publike –terasave vend parkingjeve për operatorët e auto taksi dhe qiramarrësit e lokaleve në pronësi të komunës.**

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacollit DEZH, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Alban Salihu, tha se në vazhdimisht jemi solidarizuar me hallet dhe kërkesat e bizneseve të cilat operojnë në këtë zonë, është një hap i mirë por i vonuar. Në të mbështesim këtë propozim.

Arsim Jashari, tha se kjo ka qenë një kërkesë e imja para 3 seancave që e kam ngritë për me të liruuar dhe po me vjen mirë që po mbështeten, Në si grup e mbështesim këtë propozim vendim.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 vota, aprovoi propozimin

### XIII

#### **Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për klubin futbollistik Gadimja,**

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Anila Reqices, DKRS, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Alban Salihu, tha se mendojmë që sa here mbështeten klubet sportive kur nuk është e mjaftueshme për nevojat dhe vështirësitë që ballafaqohen. Ajo që po me intereson me ditë pse klubi Gadimja nuk është përfshi në mbështetje e klubeve tjera sportive që janë mbështetur me herët në baze të thirrjeve të cilën e ka bërë komuna. Përndryshe na votojmë dhe jemi për.

Fadil Spaihu, tha se unë para disa seancave kam ngritur një kërkesë për ta mbështetur këtë klub dhe e mbështes këtë propozim pasi që është vendim i qëlluar.

Arsim Jashari, tha se kemi diskutuar për klubin e Gadimes edhe me herët, ajo që po me pëlqen që po financohen U11, U12 dhe U13, dhe është mirë që po mbështetet ky klub pasi që është në filllet e para dhe ka vështirësi.

Nexhmendin Lekiqi, tha se një klub i ri i cili ka rreth 70 anëtarë dhe nuk është ndihmuar asnjëherë, është mirë që po ju behën subvencionimi i para dhe shpresojmë që do të ju vazhdojnë subvencionet dhe do ta kenë mbështetjen tone.

Anila Reqica-LLugiqi, pavarësisht vullnetit tone që me përkrah këtë klub e kemi vërejtje që kanë probleme të mbrëmshme menaxheriale, ne po mbështesim në këtë mënyrë këtë klub.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 29 vota, aprovoi propozimin

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 14:40.

**Ekstraktin e hartoi**

**Behar Aliu**

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Daut Azemi**